

K Ë R K E S Ë P A D I

PADITËS: Gazment Bardhi, Flamur Noka, Bledion Nallbati, Saimir Korreshi, Lefter Gështenja, Luan Baçi, Dashnor Sula, Agron Gjekmarkaj, Xhelal Mziu, Ina Zhupa, Zheni Gjergji, Helidon Bushati, Lindita Metaliaj, Ramandan Likaj, Asllan Dogjani, Qani Xhafa, Flamur Hoxha, Kastriot Piroli, Lodovik Hasani, Kasem Mahmutaj, Edmond Spaho, Edi Paloka, përfaqësuar në gjykim nga Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi dhe Av. Marash Logu, me adresë njoftimi: Zyra e Grupit të PD-së, Kuvendi i Shqipërisë, Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë.

IPADITUR: Kuvendi i Shqipërisë, me adresë njoftimi: Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë.

OBJEKTI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 59, datë 02.10.2024, të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën “Për marrje mase disiplinore”.
2. Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar zbatimin e vendimit nr. 59, datë 02.10.2024 të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën “Për marrje mase disiplinore”.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Shqipërisë;
Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
Nenet 107 dhe 109 i Kodit të Procedurave Administrative;
Nenet 7, 10, 11, 15 dhe 17 të Ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar;
Nenet 65/1, 65/2, 65/3 dhe 65/4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË

I/E Nderuar Z./Znj. Gjyqtar/e,

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Me kërkesën e datës 01.10.2024, 11 deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste kanë kërkuar marrjen e masave disiplinore ndaj deputetëve Gazment Bardhi, Flamur Noka,

Bledion Nallbati, Edi Paloka, Saimir Korreshi, Lefter Gështenja, Luan Baçi, Dashnor Sula, Agron Gjekmarkaj, Dhurata Çupi, Xhelal Mziu, Ina Zhupa, Zheni Gjergji, Helidon Bushati, Lindita Metaliaj, Ramadan Likaj, Asllan Dogjani, Qani Xhafa, Flamur Hoxha, Isuf Çelaj, Kastriot Piroli, Lodovik Hasani, Kasem Mahmutaj, Edmond Spaho.

2. Në përmbajtje të kërkesës thuhet se: *“Deputetët Gazment Bardhi, Flamur Noka, Bledion Nallbati goditën me mjete shumë të forta drejt Kryetares së Kuvendit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, mjete të cilat mund të rrezikonin jetën, dhe vënia në rrezik e jetës brenda sallës së Kuvendit të Shqipërisë është e papranueshme. Deputetët e opozitës vijuan me kaosin në sallë duke nxjerrë jashtë nga salla e parlamentit karriget e të cilëve më pas u vendosën flakën, duke rrezikuar kështu përhapjen e flakëve në godinë. Deputetët Gazment Bardhi, Flamur Noka dhe Bledion Nallbati nuk lejuan që deputetët Erion Braçe dhe Petro Koçi të mbanin fjalët e tyre duke i marrë kartën dhe dëmtuar pajisjen elektronike. Deputetët kanë tentuar gjithashtu të mos lejojnë të mbante fjalën dhe Kryetari i grupit Niko Peleshi dhe Nënkryetari i Grupit Toni Gogu duke krijuar tensione.”.*
3. Me vendimin nr. 59, datë 02.10.2024, Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën ka vendosur: *“1. “Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për deputetët Gazment Bardhi, Flamur Noka, Bledion Nallbati me 60 ditë”, duke filluar nga data 03.10.2024 deri më datën 01.12.2024. 2. “Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 40 ditë” për deputetët Saimir Korreshi, Lefter Gështenja, Luan Baçi, Dashnor Sula, Agron Gjekmarkaj, Dhurata Çupi, Xhelal Mziu, Ina Zhupa, Zheni Gjergji, Helidon Bushati, Lindita Metaliaj, Ramadan Likaj, Asllan Dogjani, Qani Xhafa, Flamur Hoxha, Isuf Çela, Kastriot Piroli, Lodovik Hasani, Kasem Mahmutaj, Edmond Spaho, duke filluar nga data 03.10.2024 deri më datë 11.11.2024. 3. “Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 ditë” për deputetin Edi Paloka, duke filluar nga data 03.10.2024 deri më datë 12.10.2024. 4. Ngarkohet “Shërbimi i Sigurisë në Kuvend” dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për zbatimin e këtij vendimi. 5. Ky vendim mund të ankimohej nga deputeti brenda 2 (dy) ditëve pranë Byrosë së Kuvendit. 6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 03.10.2024.”. [Prova nr. 1 – Vendimi i shkurtuar nr. 59, datë 02.10.2024 i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën]*
4. Ky vendim është publikuar vetëm në formatin i shkurtuar, prandaj arsyet e kësaj vendimmarrje mbeten akoma tërësisht të pazbardhura. Megjithatë, në kushtet kur neni 65/3, pika 1, e Rregullores së Kuvendit, parashikon një afat dy ditor për ushtrimin e ankimit, është paraqitur ankimi në Byronë e Kuvendit, duke iu referuar pretendimeve të ngritura në kërkesën e 11 deputetëve të Grupit Parlamentar të PS-së, me presupozimin se ato pretendime janë gjetur të drejta nga anëtarët e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën. Ankimi nuk është marrë në shqyrtim nga Byroja e Kuvendit, duke lënë në fuqi vendimin nr. 59/2024 të Sekretariatit. [Prova nr. 2 – Ankim ndaj vendimit nr. 59/2024 të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën]

II. E DREJTA E APLIKUESHME

5. Kushtetuta e Shqipërisë:

(i) **Neni 42** parashikon: “1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të çënohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykata e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”.

6. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

(i) **Neni 6** parashikon: “1. Cdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”.

7. Kodi i Procedurave Administrative:

(i) **Neni 4** parashikon: “1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. 2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të çënohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.”.

(ii) **Neni 5** parashikon: “Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të.”.

(iii) **Neni 6** parashikon: “1. Cdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit.”.

(iv) **Neni 10** parashikon: “1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre. 3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që gëzon pala sipas ligjit.”.

- (v) **Neni 12** parashikon: “1. Cdo veprim administrativ, i cili për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të çenojë interesa legjitime, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. 2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që çenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës; b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.”.
- (vi) **Neni 15** parashikon: “Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjëse për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës.”.
- (vii) **Neni 87** parashikon: “1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t’u dëgjuar.”.
- (viii) **Neni 88** parashikon: “1. E drejta e palës për t’u dëgjuar ushtrohet në çdo formë të përshtatshme dhe brenda afatit të përcaktuar nga organi publik. 2. Palët, në ushtrimin e së drejtës për t’u dëgjuar, mund të paraqesin komente edhe për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës. 3. Organi publik merr vendimin përfundimtar vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar në ushtrimin e së drejtës për t’u dëgjuar nga pala.”.
- (ix) **Neni 107** parashikon: “Akti administrativ është i ligjshëm nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në këtë Kod, si dhe legjislacionin në fuqi.”.
- (x) **Neni 109** parashikon: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: a) është rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative; d) është në kundërshtim me ligjin material; e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.”.

8. Ligji nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”:

- (i) **Neni 7** parashikon: “Gjykatat administrative janë kompetente për: a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;”.
- (ii) **Neni 10** parashikon: “1. Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normative.”.

- (iii) **Neni 11** parashikon: “1. Paditë kundër veprimit administrativ shqyrton në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet.”.
- (iv) **Neni 15** parashikon: “Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.”.
- (v) **Neni 17** parashikon: “1. Padia ngrihet: a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ.”.
- (vi) **Neni 18** parashikon: “1. Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Ky afat fillon nga: dh) data e mbarimit të afatit ligjor për shqyrtimin e ankimit administrativ, në rastet e mosveprimit të organit më të lartë administrativ.”.

9. Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë:

- (i) **Neni 65/1** parashikon: “1. Masa disiplinore “përgjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose seancë plenare deri në 10 ditë” i jepet deputetit: a) kur edhe pas tërheqjes së vëmendjes dhe dhënies së vërejtjes nga drejtuesi i seancës/mbledhjes, bën thirrje për përdorim dhune, pengon zhvillimin e rregullt të seancës plenare/mbledhjes së komisionit, shkakton kaos në seancë plenare/komision, fyen, kërcënon ose dhuron deputetët e tjerë, drejtuesin e seancës, anëtarët e Këshillit të Ministrave, të ftuarit ose persona të tjerë, apo përdor fjalë fyese për Presidentin e Republikës, Kryeministrin ose institucione të tjera shtetërore; b) kur refuzon të dalë nga salla e seancës/mbledhjes, hyn ose përpiqet të hyjë në sallë përpara mbarimit të masës disiplinore të dhënë; c) në rastet e ngacmimit seksual të çfarëdo forme, të parashikuar nga neni 10 i Kodit të Sjelljes së Deputetit. 6. Masa disiplinore “përgjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose seancë plenare deri në 30 ditë” jepet në rastet: b) kur deputeti përmes veprimeve të qëllimshme dëmton pajisjet dhe orenditë ose heq funksionalitetin e tyre logjistik në sallën e seancës/mbledhjes; c) kur deputeti kryen në mënyrë të përsëritur brenda një sesioni parlamentar shkeljet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni; 7. Masa disiplinore “përgjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 60 ditë” jepet në rastet: a) kur deputeti përdor lëndë apo mjete piroteknike, tymuese, bojëra dhe materiale të tjera të ngjashme brenda sallës së zhvillimit të punimeve të Kuvendit/mbledhjes së komisionit/brenda mjediseve të Kuvendit; 8. Kërkesa për marrjen e masës disiplinore, sipas pikave 6 dhe 7 të këtij neni, paraqitet me shkrim nga jo më pak se 7 deputetë dhe jo më vonë se 48 orë nga dita e konstatimit të ngjarjeve/rasteve.”.
- (ii) **Neni 65/2** parashikon: “1. Masa disiplinore “përgjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë, 30 ditë ose 60 ditë” jepet nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën. Mbledhja e Sekretariatit

zhvillohet brenda 48 orëve nga depozitimi i kërkesës. 2. Shqyrtimi i çështjes kryhet nëpërmjet një procedure që i garanton të drejtën e deputetit për t'u informuar për kërkesën, për t'u pyetur, për t'u dëgjuar, për të paraqitur shpjegimet e tij, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, për t'u njohur me provat dhe dokumente të tjera. 4. Masa disiplinore "përfashtim nga pjesëmarrja në seancë plenare/komisione" llogaritet në ditë pune dhe shoqërohet me sanksion financiar të ndalimit të pagës së deputetit për aq ditë sa është marrë masa disiplinore. 5. Vendimi i dhënë për rastet e parashikuara në pikën 1, shkronjat "a" dhe "b", pikat 6 dhe 7, të nenit 65/1 publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit."

- (iii) **Neni 65/3** parashikon: "1. Masat e rënda disiplinore, të dhëna sipas neneve 65 dhe 65/1 mund të ankimohen nga deputeti brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit. 2. Ankimi paraqitet me shkrim pranë Byrosë së Kuvendit. 3. Ankimi shoqërohet edhe me materialet ose dokumentet provuese. 4. Me paraqitjen e ankimit, urdhri i drejtuesit të seancës plenare/komisionit dhe/ose vendimi i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën pezullohet me vendim të ndërmjetëm të Byrosë së Kuvendit deri në dhënien e vendimit përfundimtar."
- (iv) **Neni 65/4** parashikon: "1. Byroja e Kuvendit, brenda 2 ditëve nga marrja e ankimit, shqyrton çështjen duke zhvilluar hetim administrativ që përfshin: a) marrjen e dokumentacionit të masës së dhënë nga kryetari/drejtuesi i seancës ose Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën; b) shqyrtimin e dokumenteve provuese të paraqitura nga ankuesi/kërkuesit; c) kërkimin e provave të tjera, që nuk janë shqyrtuar më parë, ose të ndonjë fakti të ri që ka dalë pas marrjes së vendimit nga drejtuesi i seancës/komisionit ose Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën. 2. Shqyrtimi i çështjes kryhet nëpërmjet një procedure që i garanton të drejtën e deputetit për t'u informuar për kërkesën, për t'u pyetur, për t'u dëgjuar, për të paraqitur shpjegimet e tij, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, për t'u njohur me provat dhe dokumente të tjera. 3. Të drejtën për të kërkuar marrjen dhe shqyrtimin e provave e ka edhe çdo anëtar i Byrosë. 4. Kur ankuesi është anëtar i Byrosë së Kuvendit, ai përjashtohet nga votimi i çështjes. 5. Nëse anëtar i Byrosë është vendimmarrës ose anëtar i një organi vendimmarrës për masën disiplinore që ankimohet, merr pjesë në shqyrtim pa të drejtë vote. 6. Byroja e Kuvendit merr vendim me shumicë votash në prani të më shumë së gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij. Në rast barazie votash, ankimi konsiderohet i rrëzuar dhe masa disiplinore lihet në fuqi. 7. Byroja e Kuvendit vendos: a) rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të masës disiplinore; b) pranimin e ankimit dhe heqjen e masës disiplinore; c) pranimin pjesërisht të ankimit dhe ndryshimin e afatit të masës disiplinore të dhënë nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën. 8. Vendimi i Byrosë është përfundimtar, i formës së prerë dhe ekzekutohet menjëherë. 9. Nëse Byroja e Kuvendit nuk mblidhet brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, vendimi i drejtuesit të seancës plenare/komisionit ose vendimi i Sekretariatit për

Procedurat, Votimet dhe Etikën merr formë të prerë. 10. Vendimi i Byrosë së Kuvendit publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.”.

III. ANALIZA LIGJORE

A. Lidhur me legjitimimin e paditësit

10. Së pari, sa i përket *legjitimitit personal* (legitimatio personae), neni 15, i Ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar (në vijim “Ligji nr. 49/2012”), ka parashikuar se: “*Të drejtën e ngritjes së padisë e ka çdo subjekt që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.*”. Në rastin konkret, paditësit pretendojnë se si rezultat i vendimit nr. 59/2024 të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën (në vijim “Sekretariati”), janë në pamundësi për të vijuar ushtrimin e detyrave të tyre si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, duke u cënuar jo vetëm interesi i tyre personal, por edhe përfaqësimi i qytetarëve që kanë zgjedhur deputetët e përjashtuar nga pjesëmarrja në komisione parlamentare dhe në seancë plenare për 40 – 60 ditë. Në këtë kuptim, paditësit gëzojnë legjitimimin personal për paraqitjen e kësaj padie.

11. Së dyti, sa i përket *legjitimitit në kohë* (legitimatio temporis), neni 18, pika 1, e Ligjit nr. 49/2012 parashikon se: “*Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Ky afat fillon nga: dh) data e mbarimit të afatit ligjor për shqyrtimin e ankimit administrativ, në rastet e mosveprimit të organit më të lartë administrativ.*”. Në rastin konkret, paditësit kanë kërkuar shfuqizimin e një akti administrativ, i cili në formën e tij të shkurtuar është publikuar në faqen e Kuvendit të Shqipërisë në datën 02.10.2024. Në datën 03.10.2024, paditësit kanë ushtruar të drejtën e ankimit pranë Byrosë së Kuvendit. Duke qenë se kjo e fundit nuk është mbledhur brenda afatit 2-ditor, vendimi ka marrë formë të prerë në datën 07.10.2024, çka do të thotë se afati për paraqitjen e padisë është data 22.11.2024. Kjo padi po paraqitet brenda këtij afati, e në këtë kuptim, paditësi gëzon legjitimimin në kohë për paraqitjen e saj.

B. Lidhur me kompetencën e gjykatës

12. Së pari, sa i përket *kompetencës lëndore*, neni 7, i Ligjit nr. 49/2012, parashikon se “*Gjykatat administrative janë kompetente për: a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative të organit publik.*”. Në rastin konkret, padia ka për objekt shfuqizimin e një akti administrativ individual, përkatësisht vendimin nr. 59/2024 të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën, çka

do të thotë se gjykatat administrative janë kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj padie.

13. Së dyti, sa i përket *kompetencës funksionale*, neni 10, i Ligjit nr. 49/2012, përcakton se “1. *Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normative.*”. Pra, të gjitha mosmarrëveshjet që lidhen me akte administrative individuale janë në kompetencën e gjykatave administrative të shkallës së parë, ndërsa gjykata administrative e apelit është kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lidhen me akte normative nënligjore, si dhe me shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të gjykatave administrative të shkallës së parë. Në rastin konkret, padia ka për objekt shfuqizimin e një akti administrativ individual, çka do të thotë se kompetencën funksionale e ka gjykata administrative e shkallës së parë.
14. Së treti, sa i përket *kompetencës tokësore*, neni 11, i Ligjit nr. 49/2012, parashikon se “1. *Paditë kundër veprimit administrativ shqyrton në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet.*”. Në rastin konkret, duke qenë se akti administrativ individual është nxjerrë nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën, një organ i Kuvendit të Shqipërisë, me qendër në qytetin e Tiranës, atëherë kompetencën tokësore për shqyrtimin e kësaj padie, e ka Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
- C. *Lidhur me paligjshmërinë e vendimit nr. 59/2024 të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën*
15. Kodi i Procedurave Administrative ka sanksionuar se një akt administrativ është i ligjshëm nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në këtë Kod, si dhe legjislacionin në fuqi (*shih nenin 107*). Në vijim, Kodi ka përcaktuar rastet kur një akt administrativ është i paligjshëm, përkatësisht: a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës; b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi; d) është në kundërshtim me ligjin material; dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit (*shih nenin 109*). Sic do të analizojmë në vijim, akti administrativ individual, objekt i kësaj padie, përmbush tre prej rasteve për t’u konsideruar i paligjshëm, e për rrjedhojë për t’u shfuqizuar, përkatësisht akti është rezultat i shkeljes së dispozitave që lidhen me procedurën administrative, është në kundërshtim me ligjin material dhe nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

16. Së pari, sa i përket shkeljeve në procedurën administrative të nxjerrjes së aktit, neni 42 i Kushtetutës sanksionon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa u garantuar një proces i rregullt ligjor, që nënkupton sigurimin e një sërë garancish procedurale që kanë të bëjnë me mundësinë për t'u njoftuar, për t'u informuar, për t'u njohur me aktet, për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të kundërshtuar, për t'u ankuar në rrugë administrative, dhe për t'iu drejtuar eventualisht gjykatës. Kjo e drejtë gëzon mbrojtje të posaçme edhe nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Të njëjtat garanci sa i përket të drejtës për një proces të rregullt ligjor, i gjejnë të sanksionuara edhe në dispozita të ndryshme të Kodit të Procedurave Administrative.
17. Në nenin 4, pika 2, të KPA, e gjejnë të përcaktuar shprehimisht se të drejtat dhe interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cënohen nga veprimi administrativ, përveç kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor. Në dispozitat vijuese, në formën e parimeve, gjejnë të materializuara disa prej elementëve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, siç janë transparenca (neni 5), informimi (neni 6), dhënia e ndihmës aktive (neni 10), dhe e drejta për t'u dëgjuar (neni 87). Parimi i transparencës nënkupton detyrimin e organit publik për të vepruar në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë a juridikë të përfshirë në një procedurë administrative. Ndërsa, parimi i informimit nënkupton detyrimin e organit publik për të informuar çdo person lidhur me ecurinë e një procedurë administrative. Dhënia e ndihmës aktive nënkupton mundësinë e çdo pale të përfshirë që të ndjekë dhe mbrojë në mënyrë efektive të drejtat e saj, ndërsa e drejta për t'u dëgjuar sanksionon mundësinë e palës për të paraqitur komente, shpjegime dhe vlerësime lidhur me procedurën administrative.
18. Duke u kthyer në rastin konkret, rezultojnë se kërkesa për marrjen e masave disiplinore ndaj 24 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është kryer nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën, i cili ka në përbërje të tij tre deputetë nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste dhe dy deputetë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike. Për shkak se masa disiplinore ishte kërkuar edhe ndaj dy deputetëve të PD-së (Bledion Nallbati dhe Saimir Korreshi), anëtarë të këtij Sekretariati, në mbledhje kanë marrë pjesë vetëm tre anëtarët, deputetë të PS-së. Pra, praktikisht tre deputetë të PS-së kanë shqyrtuar një kërkesë të njëmbëdhjetë kolegëve të tyre, po deputetë të PS-së, çka cënon në mënyrë flagrante parimin e procesit të rregullt ligjor, në drejtim të parimit të paanshmërisë, që sanksionon neni 42, pika 2, e Kushtetutës dhe neni 65/2, pika 2, e Rregullores së Kuvendit. Kjo pasi, është e kuptueshme që vendimmarrja ka qenë e paracaktuar, pavarësisht se si qëndronin faktet dhe e vërteta.
19. Nga ana tjetër, megjithëse neni 42, pika 2, e Kushtetutës, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 4, pika 2 dhe neni 87 i Kodit të Procedurave Administrative, si dhe neni 65/2, pika 2, e Rregullores së Kuvendit garantojnë të drejtën e deputetit ndaj të

cilit kërkohet masa disiplinore për t'u njoftuar, për t'u informuar, për t'u njohur me aktet, për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të kundërshtuar, për t'u ankuar në rrugë administrative, dhe për t'iu drejtuar eventualisht gjykatës, në rastin konkret rezulton se deputetëve nuk iu është dhënë mundësia as për t'u pyetur, as për t'u dëgjuar, as për të paraqitur shpjegimet e tyre apo për t'u njohur me provat dhe dokumentet e tjera, pasi tre deputetët e Partisë Socialiste janë mbledhur në një zyrë të mbyllur dhe kanë marrë vendimin për përjashtimin e kolegëve të tyre, kundërshtarë politikë. Për sa më sipër, është e qartë se të drejtat e paditësit janë cënuar pa një proces të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës, nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 5, 6, 10 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe nenit 65/2, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, çka do të thotë se akti është i paligjshëm e për rrjedhojë duhet shfuqizuar në kuptim të nenit 109, gërma "b", të Kodit të Procedurave Administrative.

20. Së dyti, sa i përket shkeljeve të ligjit material, Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën, duke referuar nenin 65/1, pika 7, gërma "a", ka vendosur masën disiplinore përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 60 ditë për deputetët Gazment Bardhi, Flamur Noka, Bledion Nallbati, dhe masën disiplinore përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 40 ditë për 20 deputetët e tjerë, përkatësisht Saimir Korreshi, Lefter Gështenja, Luan Baçi, Dashnor Sula, Agron Gjekmarkaj, Dhurata Çupi, Xhelal Mziu, Ina Zhupa, Zheni Gjergji, Helidon Bushati, Lindita Metaliaj, Ramadan Likaj, Asllan Dogjani, Qani Xhafa, Flamur Hoxha, Isuf Çela, Kastriot Piroli, Lodovik Hasani, Kasem Mahmutaj, Edmond Spaho.
21. Neni 65, pika 7, gërma "a", e Rregullores së Kuvendit parashikon se: "*Masa disiplinore "përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 60 ditë", jepet në rastet kur deputeti përdor lëndë apo mjete piroteknike, tymuese, bojëra dhe materiale apo mjete të tjera të ngjashme brenda sallës së zhvillimit të punimeve të Kuvendit/mbledhjes së komisionit/brenda mjedisëve të Kuvendit.*". Pra, përjashtimi i deputetëve për 40-60 ditë mund të ndodhë vetëm në këto rrethana. Veprimet e 23 deputetëve të opozitës janë publike dhe asnjëri prej tyre nuk gjendet në rrethanat e parashikuara nga dispozita e sipërcituar. Në këto kushte, kjo vendimmarrje cënon një prej parimeve themelore të së drejtës "*nulla poena, sine lege*", që do të thotë "*nuk ka dënim, pa ligj*", parim i sanksionuar edhe në nenin 29 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenin 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që i referohet proceseve penale, por që aplikohet *mutatis mutandis* edhe në proceset administrative.
22. Nga ana tjetër, sa i përket përjashtimit të deputetit Edi Paloka nga pjesëmarrja në komisione dhe seancë plenare për 10 ditë, duke iu referuar nenit 65/1, pika 1, gërma "a", që parashikon rastet kur deputeti edhe pas tërheqjes së vëmendjes dhe dhënies së vërejtjes nga drejtuesi i seancës/mbledhjes, bën thirrje për përdorim dhune, pengon zhvillimin e rregullt të seancës plenare/mbledhjes së komisionit, shkakton kaos në seancë plenare/komision, fyen,

kërcënon ose dhunon deputetët e tjerë, drejtuesin e seancës, anëtarët e Këshillit të Ministrave, të ftuarit ose persona të tjerë, apo përdor fjalë fyese për Presidentin e Republikës, Kryeministrin ose institucione të tjera kushtetuese, rezulton se në rastin konkret deputetit Paloka as nuk i është tërhequr vëmendja, as nuk i është dhënë vërejtje dhe as nuk ka kryer ndonjë prej veprimeve të parashikuara nga dispozita e mësipërme. Për sa më sipër, është e qartë se masat e përjashtimit 40 – 60 ditë ndaj 23 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë nuk janë në përputhje me nenin 65, pika 7, gërma “a”, çka do të thotë se vendimi nr. 59/2024 është në kundërshtim me ligjin, e për rrjedhojë jemi në kushtet e nenit 109, gërma “d”, të KPA, dhe vendimi nr. 59/2024 i Sekretariatit duhet shfuqizuar.

23. Së treti, sa i përket shkeljes së parimit të proporcionalitetit, neni 12 i KPA-së parashikon se cdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të çenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që çenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës; i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.
24. Në vendimin nr. 48, datë 19.06.2024, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: *“Për sa i përket parimit të demokracisë përfaqësuese, Gjykata vëren se ai buron nga neni 1, pika 2, i Kushtetutës, që parashikon se Shqipëria është republikë parlamentare, si dhe neni 2, pikat 1 dhe 2, i saj, që sanksionojnë sovranitetin si parim themelor të ekzistencës së shtetit, i cili i përket popullit, që e ushtron nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti. Nga parimi i demokracisë përfaqësuese rrjedh detyrimi i deputetit që mandatin e besuar nga zgjedhësit ta ushtrojë realisht. Koncepti i mandatit parlamentar përmban detyrimin e përfaqësimit real të zgjedhësve. Populli merr pjesë në vendimmarrjen parlamentare nëpërmjet tërësisë së anëtarëve të tij dhe për këtë qëllim duhet të garantohet pjesëmarrja e të gjithë deputetëve në vendimmarrje sipas kuadrit kushtetues. Sipas Gjykatës, vetëm duke qenë plotësisht efektiv, pra i përfaqësuar tërësisht me të gjithë anëtarët e tij, parlamenti mund të realizojë funksionin e tij demokratike. Nëse një deputet, për arsye të ndryshme, ndalohet ose pengohet të ushtrojë funksionin e tij si pjesë e parlamentit, atëherë çënohet parimi i përfaqësimit, si dhe raporti shumicë/pakicë i vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe që duhet të gjejë patjetër pasqyrim në parlament gjatë gjithë legjislaturës.”.*
25. Duke cituar vendimin Karacsony dhe të tjerë kundër Hungarisë, datë 17 maj 2016, Gjykata sjell në vëmendje se: *“Në veçanti duhet të arrihet një ekuilibër i cili siguron trajtimin e drejtë dhe të duhur të njerëzve që vijnë nga pakicat dhe shmang abuzimin e një pozicioni dominues. Prandaj, me autonominë parlamentare nuk duhet të abuzohet me qëllim shtypjen e lirisë së shprehjes së deputetëve. Rregullat për funksionimin e brendshëm të parlamentit nuk duhet të shërbejnë si bazë që shumica parlamentare të abuzojë me pozitën*

e saj dominuese përballë opozitës.”. Më tej, Gjykata thekson se: “Edhe pse Kuvendi, parimisht, ka mandatin kushtetues që të ndërhyjë për rregullimin edhe të atyre çështjeve që kanë të bëjnë me përcaktimin e sjelljeve/veprimeve që përbëjnë shkelje disiplinore, parimi i proporcionalitetit kërkon që ndërhyrja të jetë në gjendje të arrijë vetëm ato objektiva të ligjshëm që synohen, pa shkuar përtej asaj që është e nevojshme në këtë drejtim. Kjo nënkupton se nëse qëllimi i ndërhyrjes është arritja me çdo kusht e objektivit të synuar, pa analizuar dhe pa marrë në konsideratë efektet negative të saj, parimi i proporcionalitetit konsiderohet se nuk është respektuar.”.

26. Nisur nga jurisprudenca e mësipërme e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është e qartë se në rastin konkret masat disiplinore të përjashtimit 40-60 ditë të 23 deputetëve të opozitës çënon parimin e përfaqësimit, si dhe raportin shumicë/pakicë të vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe që duhet të gjejë pasqyrim gjatë gjithë legjislaturës. Nga ana tjetër, është e qartë se vendosja e këtyre masave kaq të ashpra është një abuzim i shumicës parlamentare me pozitën e saj dominuese përballë opozitës. Dhe për më tepër, nisur nga rrethanat konkrete të përshkruara në kërkesën e datës 01.10.2024 të 11 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, është e qartë se kemi të bëjmë me masa disiplinore joproporcionale, që kanë për qëllim ndëshkimin politik të deputetëve të opozitës për aktet e tyre të protestës, brenda dhe jashtë sallës së Parlamentit. Përdorimi i forcës së kartonave nga mazhoranca në strukturat parlamentare, ku ajo sigurisht ka shumicën, për të përjashtuar opozitën nga veprimtaria parlamentare, vjen në kundërshtim me konkluzionet e vendimit nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe parimin e proporcionalitetit, e për rrjedhojë jemi në kushtet e nenit 109, gërma “e”, të Kodit të Procedurave Administrative, dhe vendimi nr. 59/2024 i Sekretariatit duhet shfuqizuar.

D. *Lidhur me pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 59/2024 të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën*

27. Neni 202 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se me kërkesë të palës paditëse, lejohet marrja e masës së sigurimit të padisë kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Ndërkaq, neni 180 i Kodit të Procedurës Administrative citon se: *“Ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit në rastet kur: a) vërtetohet se ekziston rreziku i shkakimit të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e çënon interesit publik.”*
28. Në proceset gjyqësore me karakter administrativ duhet t’i referohemi nenit 28 të ligjit Nr. 49/2012 *“Për Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative dhe Gjykatat Administrative”*, i cili parashikon se *“Me paraqitjen e padisë, paditësi mund t’i kërkojë gjykatës marrjen e*

masave të sigurimit të padisë në rastet kur ai tregon se gjatë kohës së nevojshme të procesit, dërsa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ.”

29. Ndërkohë, neni 29 parashikon kushtet që duhet të plotësohen për marrjen e masës së sigurimit të padisë, përkatësisht: “a) ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, i bazuar në shkresa për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin (*periculum in mora*); b) nuk cënohet interesi publik.” Të njëjtin interpretim ka mbajtur edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimet me nr. 71/383, datë 27.05.2020; vendimi nr. 158/524, datë 27.05.2020; vendimi nr. 159/525, datë 27.05.2020; vendimi nr. 181, datë 27.05.2020 dhe vendimi nr. 212, datë 27.05.2020. Në vijim do të analizojmë secilin prej kushteve të parashikuara nga neni 29 i ligjit Nr. 49/2012, të aplikuara në rastin konkret.
30. Kushti i parë: dëmi i rëndë, i pakthyeshëm dhe i atëçastshëm: Masat e përjashtimit nga pjesëmarrja në komisione parlamentare dhe seancë plenare për 40 – 60 ditë është e qartë se sjellin një dëm të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për 23 paditësit, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët si rezultat i aplikimit me efekt të menjëhershëm (dëmi i atëçastshëm) të këtyre masave nuk mund të ushtrorjnë funksionet e tyre kushtetuese, përkatësisht funksionin legjislativ, kontrollues dhe zgjedhës. Po ashtu, si rezultat i aplikimit të këtyre masave cënohet parimi i demokracisë përfaqësuese, siç është shprehur Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 48, datë 19.06.2024, pasi mbeten pa përfaqësim qytetarët që kanë votuar dhe zgjedhur këta deputetë të përjashtuar (dëmi i rëndë). Nga ana tjetër, pasur parasysh kohëzgjatjen normale të procesit gjyqësor, është e qartë se në përfundim të këtij procesi masat disiplinore do ta kenë ezauruar të plotë efektin e tyre, duke sjellë që në eventualitetin e pranimit të kësaj padie, vendimi gjyqësor të mos ketë asnjë efekt për interesat e ligjshëm të paditësve (dëmi i pakthyeshëm).
31. Kushti i dytë: moscënimi i interesit publik: Edhe ky kusht vlerësojmë se përmbushet plotësisht pasi nga pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 59/2024 për përjashtimin e 23 deputetëve me 40 – 60 ditë, jo vetëm nuk cënohet interesi publik, por mbrohet një prej parimeve themelore të Kushtetutës tonë (shih nenin 1, pika 2, dhe nenin 2, pika 1), parimi i demokracisë përfaqësuese. Nëpërmjet pezullimit të këtij vendimi garantoher vijimi i ushtrimit të mandatit parlamentar të 23 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, që përfaqësojnë 1/6 e totalit të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe garantoher përfaqësimi real i qytetarëve që kanë votuar dhe zgjedhur këta deputetë në Kuvendin e Shqipërisë. Po ashtu, siç është shprehur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 48/2024: “Vetëm duke qenë plotësisht efektiv, pra i përfaqësuar tërësisht me të gjithë anëtarët e tij, parlamenti mund të realizojë funksionin e tij demokratike. Nëse një deputet, për arsye të ndryshme, ndalohet ose pengohet të ushtrorjë funksionin e tij si pjesë e parlamentit, atëherë cënohet parimi i përfaqësimit, si dhe raporti shumicë/pakicë i vendosur nga vullneti i

zgjedhësve dhe që duhet të gjejë patjetër pasqyrim në parlament gjatë gjithë legjislaturës.”. Për sa më sipër, vlerësojmë se kjo kërkesë është e bazuar në ligj dhe në prova, e për rrjedhojë duhet pranuar, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm se paditësve mund t’iu vijë një dëm i rëndë, i pakthyesëm dhe i atëçastshëm përgjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj padie.

IV. KONKLUZIONE

32. Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në mbështetje të nenit 42, të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neneve 107 dhe 109, të Kodit të Procedurave Administrative, neneve 65/1, 65/2, 65/3 dhe 65/4 të Rregullores së Kuvendit, dhe neneve 7–17, të Ligjit nr. 49/2012, *përfundimisht*,

KËRKOJMË:

- Shfuqizimin e vendimit nr. 59, datë 02.10.2024, të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën “Për marrje mase disiplinore”.
 - Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar zbatimin e vendimit nr. 59, datë 02.10.2024 të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën “Për marrje mase disiplinore”.
- **Bashkëlidhur gjeni:**
- (i) Prova nr. 1 – Vendimi i shkurtuar nr. 59, datë 02.10.2024 i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën;
 - (ii) Prova nr. 2 – Ankim ndaj vendimit nr. 59/2024 të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën;

Me konsideratë,
DEPUTETËT